



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 17.07.2024

Nr: 89

Ora: 15:43

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË QENDRESA QYTETARE, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR
VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR Kryetar TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT
2024

Sot në datën 17.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Qendresa Qytetare, me adresë në "Ali Pashe Gucia" Street, P 42, Tërana;


OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

Data: 17.07.2024

Nr: 89

Ora: 15:43



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e
zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë
të datës 4 gusht 2024

V Ë R E J:

Qendresa Qytetare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 3 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 16.07.2024.

Qendresa Qytetare, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqërues i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:


Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 3 vëzhguesve të Qendresa Qytetare për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 17.07.2024 Nr: 89
Ora: 15:43



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

2

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te Qendresa Qytetare

	Emri	Mbiemri	Mandati	Seriali	Zona e vëzhgimit
1.	Dragana	Kurti	Afatgjate	000006	Vlorë
2.	Rigels	Xhemollari	Afatgjate	000007	Vlorë
3.	Migen	Qiraxhi	Afatgjate	000008	Vlorë

Data: 17.07.2024 Nr: 89
Ora: 15:43



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024